

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-150/15

**Prishtinë,
7 Mars 2018**

Në çështjen juridike të:

M.A.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it dhe Ragip Namani gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: “KKPK”), KPCC/D/R/247/2014, (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA29582), të datës 18 qershor 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 7 Mars 2018 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M. A. kundër Vendimit KPCC/D/R/247/2014, të datës 18 qershor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA29582.
2. Priset Vendimi KPCC/D/R/247/2014, i datës 18 qershor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA29582.
3. Hedhet poshtë kërkesa e M. A. e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA29582, lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të pronës shoqërore për shkak të mungesës së juridiksionit të KKPK-së.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 27 shkurt 2007, M.A. (në tekstin e mëtejme “pala ankuese”) ka paraqitur kërkesë në AKP, ku kërkonte të drejtën e shfrytëzimit dhe ri-posedimin ndaj banesës me sipërfaqe prej 55.23 m², që ndodhet në Ferizaj, Rruga “Kralj Petar I”, Lamela A (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Ai kishte theksuar se ai kishte të drejtën e qiramarrjes ndaj pronës së kërkuar dhe se humbja e posedimit ndaj saj kishte ndodhur më 16 qershor 1999 si rezultat i rrethanave gjatë viteve 1998/1999 në Kosovë.
2. Për të mbështetur kërkesën, pala ankuese kishte dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
 - Kopjen e Vendimit të Ndarjes nr.1278 të lëshuar nga ndërmarrja shoqërore “Industria Metalike e Kosovës” më 30 dhjetor 1982, mbi bazën e së cilit palës ankuese i ishte ndarë në shfrytëzim prona e kërkuar;
 - Kopjen e Kontratës së Qiramarrjes të banesës nr. 173, të lidhur më 9 shkurt 1983 ndërmjet Ndërmarrjes Publike Banesore të Ferizajt si qiradhënës dhe palës ankuese si qiramarrës, mbi bazën e së cilës pala ankuese kishte pranuar pronën e kërkuar në shfrytëzim të përhershëm.
3. Më 16 nëntor 2007, AKP-ja kishte bërë njoftimin e kërkesës dhe e kishte gjetur atë të zënë nga I. Z. (në tekstin e mëtejme “pala përgjegjëse në ankesë”). Ai kishte nënshkruar Njoftimin e Pjesëmarrjes ku kishte sqaruar se ai ishte duke e shfrytëzuar pronën e kërkuar vetëm për banim dhe se nuk pretendonte asnjë të drejtë ligjore ndaj saj.
4. Më 6 dhjetor 2007, pala përgjegjëse në ankesë kishte dorëzuar përgjigje në kërkesë ku ai kishte deklaruar se ai e shfrytëzonte pronën e kërkuar pasi që nuk kishte zgjidhje tjetër, sepse prona e tij ishte djegur gjatë konfliktit. Pala përgjegjëse në ankesë kishte treguar interesimin e tij për të kontaktuar palën ankuese për të arritur një marrëveshje lidhur me pronën e kërkuar.
5. Sipas raporteve të verifikimit të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, dokumentet e prezantuar nga pala ankuese nuk ishin gjetur në institucionet kompetente dhe kështu verifikimi kishte rezultuar negativ.
6. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte kontaktuar palën ankuese dhe e kishte njoftuar atë për të gjeturat, dhe për më shumë ai ishte udhëzuar të paraqiste dokumente shtesë për të dëshmuar të drejtën e tij.
7. Gjithashtu, më 12 maj 2014, palës ankuese i ishte dërguar letra zyrtare informuese ku ai udhëzohej se nëse nuk dorëzonte dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar, kërkesa e tij mund të refuzohej nga Komisioni (faqe nr. 124 të dosjes së lëndës).
8. Më 18 qershor 2014, KKPK-ja kishte refuzuar kërkesën me vendimin e saj KPCC/D/R/247/2014. Në arsyetimin e saj KKPK-ja kishte theksuar se paraqitësi i kërkesës nuk kishte dorëzuar kurrfarë prove apo çfarëdo prove që do mund të verifikohej nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së se paraqitësi i kërkesës gëzon çfarëdo të drejte pronësore mbi pronën e kërkuar.
9. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 22 tetor 2014. Ankesa ishte paraqitur më 4 nëntor 2014. AKP-ja nuk i kishte dorëzuar vendimin palës përgjegjëse në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

10. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKKP-së përmban shkelje thelbësore të aplikimit të së drejtës materiale, si dhe se ai mbështetet mbi vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike.
11. Pala ankuese thekson se arsyetimi i Vendimit të KKKP-së aspak nuk qëndron sepse ai ka dorëzuar prova të mjaftueshme për të dëshmuar se ai kishte të drejtën e shfrytëzimit ndaj pronës së kërkuar, ndërsa Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk kishte dhënë asnjë shpjegim konkret se përse dokumentet nuk ishin verifikuar.

Arsyetimi ligjor

12. Pala ankuese kishte kërkuar vërtetimin e të drejtave të tij pronësore mbi pronën e kërkuar dhe urdhërimin e ri-posedimit ndaj saj.
13. Pas shqyrtimit të provave të mbledhura gjatë procedurës pranë AKP-së dhe përmbajtjes së ankesës, Gjykata Supreme nuk pajtohet se pretendimet e palës ankuese nuk janë të bazuara.
14. Çështja që së pari duhet të merret në konsideratë në rastin në fjalë është nëse KKKP-ja ka pasur kompetencë të shqyrtoj kërkesën e palës ankuese të paraqitur në AKP në vitin 2007, ku ai kishte kërkuar të drejtën e shfrytëzimit mbi pronën shoqërore.
15. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedimin e pronës së paluajtshme private ndaj së cilës ai/ajo aktualisht nuk është në gjendje të ushroj të drejtat e tilla pronësore për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 apo rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt. Sipas nenit 2, pika 2.1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 “Çdo person i cili ka pasur të drejtë të pronësisë, posedim ligjor apo çfarëdo të drejte tjetër ligjore të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk mund të ushrojë të drejtën e tij/saj pronësore për shkak të rrethanave që janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur gjatë viteve 1998/1999, ka të drejtë rikthimi të së drejtës pronësore, si bartës i së drejtës pronësore”. Rregullorja megjithatë, nuk zbatohet ndaj të drejtave pronësore apo të drejtave të shfrytëzimit mbi pronën publike/shoqërore.
16. Banesa në fjalë nuk ishte pronë e paluajtshme private, siç ishte theksuar edhe nga vet pala ankuese, edhe në ankesën e tij. Banesa ishte nën pronësi të ndërmarrjes shoqërore “Industria Metalike e Kosovës”, që do të thotë se ajo ishte pronë shoqërore. Për këtë arsye, kërkesa, e cila ka pronën e paluajtshme shoqërore si çështje lëndore, bie jashtë fushëveprimit të procedurave pranë AKP-së.
17. Prandaj, vendimi i KKKP-së duhet të priset *ex officio* pasi që lënda nuk bie në kuadër të kompetencave të saj. KKKP-ja nuk është dashur të vendoste lidhur me meritat e lëndës por është dashur të hedhë poshtë atë në përputhje me nenin 11.4 (a) të Ligjit nr. 03/L-079. Pasi që kjo nuk ishte bërë, vendimi i kundërshtuar duhet të priset *ex officio* dhe kërkesa të hedhet poshtë (argumenti sipas nenit 198.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore [në tekstin e mëtejme “LPK”] i cili zbatohet *mutatis mutandis* për procedurën para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079). Sipas nenit të lartpërmendur nëse gjykata e shkallës së parë ka lëshuar një vendim lidhur me një kërkesë e cila nuk bie brenda kompetencave të saj, gjykata e shkallës së dytë duhet ta anuloj atë vendim dhe të hedhë poshtë kërkesën.
18. Së pari pala ankuese kishte theksuar se KKKP-ja kishte refuzuar kërkesën e tij sepse pala ankuese nuk kishte dorëzuar ndonjë provë me të cilat do ta dëshmonte të drejtën e tij, vendimi i referohej “paragrafëve përkatës” të vendimit grupor. Një referencë e veçantë i është bërë paragrafit 25 të vendimit dhe sipas tij Komisioni kishte konstatuar se kërkesa binte në kuadër të kompetencave të Komisionit. Më pas, pala ankuese kishte pohuar se prona e kërkuar i ishte ndarë atij nga ndërmarrja shoqërore “Industria Metalike e Kosovës”.

19. Megjithatë, çështja nëse pala ankuese me të vërtetë kishte pasur të drejtën e banimit ndaj pronës së kërkuar mbetet e parëndësishme në këtë procedurë pasi që vërtetimi i një të drejte të tillë ndaj pronës shoqërore nuk mbulohet nga kompetenca lëndore e KKPK-së (neni 3.1 (b) i Ligjit nr. 03/L-079), dhe respektivisht Kolegjit të Apelit të AKP-së.
20. Bazuar në atë që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 198.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i kolegjit

Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it

Ragip Namani , gjyqtar

Timo Eljas Torkko, ushtrues detyre i referentit të EULEX-it